



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Selmans Network shpk" të datës 03.03.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i këndeve të lodrave dhe fushave sportive në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-26-14-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Selmans Network shpk" të datës 03.03.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i këndeve të lodrave dhe fushave sportive në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-26-14-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Selmans Network shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 03.03.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i këndeve të lodrave dhe fushave sportive në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-26-14-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

"Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës, gjatë Egzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të Tendereve, ka vepruar në kundërshtim me Njoftimin për Kontratë, Dosaj e tenderit, FDT, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1&9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional, ka vlerësuar në kundërshtim me kërkesat e dhëna në dosjën e tenderit apo me mirë të themi nuk ka vlerësuar fare kërkesat e dosjës së tenderit të përcaktuara nga vet AK. OE i shpallur fitues në ofertën e tij nuk ka dorëzuar fare katalog, autorizim dhe as garancion për produktin me nr. 21 e kerkuar në FDT. OE i shpallur fitues ne Oferten e tij ka dorëzuar disa Dy lloje te katalogjeve, garancioneve dhe autorizimeve per produktet e kerkuara nga dy kompani të ndryshme. Dhe ketu qendron problemi me i madh tek dokumentacioni i ofertës. NTP Daqa pa pasur autorizime nga prodhuese jo se jo por as nga dileri mashtron ne garancionin e tij duke dhenë garancione në emer të vetin dhe duke i paraqitur ato si garancione të prodhuesit. OE I shpallur fitues edhe pse ka dorësuar dy lloje të autorizimeve nga një kompani dhe një diler nga polonia, këto dokumente nuk përmbushin kërkesat e FDT dhe të Dosjës së tenderit ngase Autorizimet e Dorëzuar nga kompania turke nuk përmbushin kërkesat dhe specifikimet teknike te Dosjës së tenderit ndersa Autorizimet e dorëzuara nga Kompania Polake janë Autorizime të pavlefshme nga diler i paautorizuar Operatori Ekonomik i shpallur fitues ka dorëzuar autorizime dhe garancione të prodhuesit nga një subjekt që nuk është diler i autorizuar për territorin e Republikës së Kosovës. Operatori Ekonomik ankues është përfaqësuesi i vetëm i autorizuar për territorin e Kosovës për produktet e prodhuesit Encho Enchev nga Bullgaria, në bazë të kontratës së përfaqësimit ekskluziv. Për pasojë:  OE fitues nuk ka të drejtë ligjore dhe kontraktuale të furnizojë produktet e këtij prodhuesi në territorin e Kosovës. Me cka edhe nuk mund ta realizojë këtë kontratë  Autorizimet e dorëzuara janë juridikisht të pavlefshme  OE fitues nuk e përmbush kriterin e autorizimit të prodhuesit.  Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje serioze të nenit 59 dhe nenit 60 të LPP-së duke e konsideruar ofertën si të përgjegjshme. e. Lidhur me këto autorizime dhe me këto Garancione ju keni marre letër zyrtare edhe nga prodhuesi i cili ka sqaruar situaten duke ju vene në dukeje që NTP Daqa ka mashtruar me dokumentet e dorëzuara në dosjën e tenderit dhe se kjo përbën shkelje te rendë të Deklaratës nën Betim, e ku ky veprim duhet të trajtohet sipas ligjit, nga AK me kërkesë për futje në listat e zeza. Për dijenin tuaj ne po ju japim edhe kopjet e letër kembimeve të Prodhuesit Bullgar Encho Enchev me JU si AK dhe me Dilerin Polak".

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsye si në vijim:

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

**Nuk keni ofruar sigurimin e tenderit ne ofertën tuaj.**

Ne piken 13.1 dhe 13.2 te dosjes se tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) është kerkuar :

Siguria e tenderit	13.1	Shëno një nga opsionet: Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
	13.2	Shuma e Sigurimit të Tenderit është <b>10000.<sup>00</sup> euro [ Dhjete mije euro ]</b> për periudhë valide prej në ditë: <b>120</b> apo muaj:

Fillimisht duhet sqaruar që parashtruesi në asnjë pretendim nuk i ka kontestuar arsyet eliminuese. Rrjedhimisht mund të konstatohet që parashtruesi është pajtuar me arsyet eliminuese. Për këtë arsye sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore apriori janë të pabazuara në tërësi.

Sidoqoftë, pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar një nga një me çrast është konstatuar si në vijim:

Sa i përket mungesës së autorizimit për poz. 21, në ofertën e tenderuesit të rekomanduar është prezantuar katalogu ku është evidentuar produkti sipas poz. 21 ku konfirmohet se vet tenderuesi i rekomanduar është prodhues i këtij produkti i regjistruar edhe në ARBK me kodin përkatës të veprimtarisë. Përndryshe edhe nga autorizimet tjera të prezantuara mbulohet ky pozicion pa cka se vet OE është prodhues dhe nuk nevojitet fare një autorizim i tillë.

Sa i përket garancionit për punimet, AK ka kërkuar sqarime shtesë nga OE dhe është sqaruar që OE definitivisht ka ofruar garancion 100% për 5 vite sipas DT.

Sa i përket pretendimeve që janë dorëzuar dy lloje të autorizimeve ku njëra prej tyre nuk është nga prodhuesi por nga dileri i autorizuar, mund të konfirmohet që kjo është në përputhje të plotë me DT ku thuhet se autorizimet mund të jenë ose nga prodhuesi ose nga dileri i autorizuar. Po ashtu DT nuk mund të kufizoj ofertimin vetëm nga një prodhues sepse kjo do të ishte në kundërshtim me nenin 7 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.03.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.